

CV dhe pagat e nëpunësve të Akshe-së që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, kompetencat dhe detyrat e tyre

Numri i nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit : 1 (një)

Emri i nëpunësit subjekt deklarimi (Titullari) : Kryetari, Z.Andrea Shllaku

CV

Z. Andrea Shllaku, zotëron diplomë në Administrim Biznesi dhe Master Shkencor në Menaxhim Financiar dhe Politikat Europiane (Qendra Universitare e Studimeve Europiane, Universiteti i Lorenes, Francë).

Njohës në fushat e menaxhimit financiar, menaxhim projektesh, logjistike portuale, procedura doganore të import/ eksportit edhe administratës publike.

Në fillimet e karrierës ka mbajtur pozicionin e specialistit në Departamentin e Këshillimit Financiar në Deloitte Shqipëri dhe Kosovë, me fokus analizimi i pasqyrave financiare dhe vlerësimin e biznesit.

Pas kësaj, shërbeu për 2 vjet si Koordinator i fondeve IPA dhe Specialist Marketingu në Ministrinë e Inovacionit, në kuadër të përmirësimit të shërbimeve publike dhe rritjen e transparencës.

Në vazhdim për gjatë tre viteve ka mbajtur pozicionin e Përgjegjësit të Shërbimeve të Brendshme në Kryeministri, ku detyra kryesore ishte planifikimi dhe realizimi i operacioneve logjistike në nivelin më të lartë të qeverisë.

Më tej gjatë tre vjetëve si Drejtori i Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv në Autoritetin Portual Durrës, dhe më pas për dy vjet si Drejtor i Divizionit Operacional, duke mbikëqyrur operacionet portuale dhe objektivat strategjike të zhvillimit të Autoritetit Portual Durrës.

Së fundmi, ka ushtruar rolin si Këshilltar i Jashtëm për Infrastrukturat Portuale, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Zotëron gjuhët e huaja: Frengjisht, Anglisht, Italisht.

Procedura e zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të AKSHE-së.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve drejtohet nga kryetari, i cili përgjigjet për zhvillimin e veprimtarisë së këtij autoriteti, në përputhje me këtë vendim dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i kryetarit të AKSHE-së bëhen nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Kryetari i AKSHE-së, përveç detyrave të tjera:

a) siguron drejtimin e veprimtarisë së autoritetit për licencimin e veprimtarive me mallra ushtarake dhe mallra e teknologji me përdorim të dyfishtë;

b) bashkërendon veprimtarinë e autoritetit me institucione të tjera të fushës;

c) nxjerr urdhra e udhëzime, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Urdhrat e udhëzimet e kryetarit bëhen të njohura për publikun dhe personat e interesuar, nëpërmjet instrumenteve të përcaktuara në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe të sjelljes së personelit të AKSHE-së.

d) Kryetari i AKSHE-së, propozon Ministrit të Mbrojtjes në përputhje me legjislacionin në fuqi për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, emërimin, lirimin ose shkarkimi nga detyra të nëpunësve të AKSHE-së.

e) Miraton me urdhër të brendshëm kriteret për lëshimin e certifikatave:

- të përdoruesit të fundit;
- ndërkombëtare të importit;
- së mbërritjes së mallit në destinacion.

Paga e Kryetarit të AKSHE-së : Kategoria I-4